

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit N. K. nga fshati H. Q. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/IL.nr.3535/2015 të datës 09.12.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestarë në praninë e prokurorit të shtetit Musli Gashi, të akuzuarit dhe përfaqësuesit ligjor të dëmtuarit A. S. – prindi K. K. S. nga fshati Zh. Komuna e Prizrenit, me datë 07.10.2016 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

N. K. nga i ati A. dhe e ëma E. e lindur K., i lindur më datë ... në Prizren tani me banim në fshatin H. Q. Komuna e Prizrenit, ka të kryer shkollën fillore, punëtor i ndërtimtarisë, i shkurorëzuar, baba i një fëmije, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 11.06.2016, në Prizren nuk përfill dhe nuk i bindet aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren nën numrin E.nr.1651/2012 të datës 11.06.2015, me të cilin është urdhëruar që në afat prej 3 ditëve të përmbush detyrimin në të holla në shumë prej 100 €, për fëmijën e mitur A. S. i lindur gjatë bashkësisë martesore me K. K. S. dhe atë në emër të alimentacionit duke filluar prej datës 04.10.2010, caktuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren nën numrin C.nr.256/2011 të datës 05.06.2012, për të cilin është tërhequr vërejtja se mos zbatimi i aktvendimit është vepër penale, kështu i akuzuari nuk ka përfill aktvendimin e gjykatës.

Këso dore ka kryer veprën penale mos përfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 43, 46, 73 dhe nenit 401 par.1 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) e cila shumë duhet të paguhet në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 8 (tetë) ditë dënim burgu duke llogaritur 20 € për një ditë burg.

I dëmtuari A. S. nga fshati Zh. Komuna e Prizrenit nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën nën numrin PP/IL.nr.3535/2015 të datës 09.12.2015, kundër të akzuarit N. K. nga fshati H. Q. Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akzuarit. I akuzuari nuk e kundërshtoj provat në të cilat mbështetet aktakuza.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Me datë 11.06.2016, në Prizren i akuzuari N. K. me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren nën numrin C.nr.256/2011 të datës 05.06.2012 është obliguar që në emër të alimentacionit të paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 100 € fëmijën e mitur A. S. Mirëpo i akuzuari nuk i bindet dhe nuk përfill vendimin e Gjykatës Themelore në Prizren nën numrin E.nr.1651/2012 të datës 11.06.2015 me të cilin është urdhëruar që në afat prej 3 ditëve të përmbush detyrimin në të holla në shumë prej 100 €, edhe pse i është tërhequr vërejtja se mos zbatimi i aktvendimit është vepër penale, kështu i akuzuari nuk ka përfill aktvendimin e gjykatës. Nga kjo del se në veprimet e akzuarit më afër të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet e veprës penale mos përfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 të KPK.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar në seancën fillestare nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akzuarit, për shkak të cilës fare nuk ka administruar provat. Gjithashtu sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, sepse në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari me kohë ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe atë në pajtim me nenin 246 e 244 të KPPK. Prandaj në veprimet e akzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale mospërfillja e gjykatës nga neni 401 par.1 të KPK dhe për këtë gjykata të akzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanat rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, gjendja e rëndë ekonomike e akzuarit, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, çka nënkupton se ka jetuar në pajtim me rregullat pozitive, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë sepse konsideron se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së

përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarit në kontest të rregullt civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr konform nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.4 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.2046/2015 të datës 07.10.2016

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.